



DIGJITALIZIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

UDHËZUES PËR INTEGRIMIN GJINOR



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DIGJITALIZIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

UDHËZUES PËR INTEGRIMIN GJINOR



UN WOMEN SHQIPËRI

2023

Ky publikim është përgatitur nga UN Women Shqipëri në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri - Zbatimi i *acquis* të BE-së për Barazinë Gjinore” (EU4GE), që zbatohet nga UN Women dhe UNFPA dhe financohet nga Bashkimi Evropian përmes Fondit të Përshejtimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autoreve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara apo ndonjë prej organizatave të lidhura me to.

Autoret: Agustela Nini-Pavli, Ani Plaku, Katherine Belen, Dolly Wittberger

Përkthimi: Majlinda Nishku

Redaktimi: Majlinda Nishku, Monika Kocaqi

Faqosje dhe grafika: Erald Lamja

© 2023 UN Women. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

PASQYRA E LËNDËS

Shkurtesa dhe akronime	4
Hyrje	6
1. Digjitalizimi dhe TIK – çështjet gjinore kryesore në Shqipëri	10
2. Barazia gjinore dhe agjenda digjitale në kontekstin e anëtarësimit në BE	19
3. Lidhja e digjitalizimit dhe TIK me <i>acquis</i> e BE-së për barazinë gjinore	22
3.1. Përafrimi me Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së dhe treguesit përkatës	25
3.2. Instrumenti i Asistencës së Para - Anëtarësimit (IPA) III: integrimi gjinor sipas 'Rregulloreve të NDICI-t'	30
3.3. Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i OECD-DAC	30
4. Mjetet kryesore për integrimin gjinor	35
4.1. Analiza gjinore	35
4.2. Statistikat gjinore mbi digjitalizimin dhe TIK në kontekstin e Shqipërisë	36
4.3. Vlerësimi i ndikimit gjinor	38
4.4. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në digjitalizim dhe në TIK	39
4.5. Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor	40
4.6. Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor	42
5. Rekomandime të rëndësishme në sektorin e digjitalizimit dhe TIK	43

LISTA E FIGURAVE, KUTIVE DHE TABELAVE

Figura 1: Pjesëmarrja e vajzave dhe djemve në arsimin e lartë	11
Figura 2: Pjesëmarrja e vajzave dhe djemve në studime të lidhura me TIK-un	11
Figura 3: Përqindja e grave dhe burrave të diplomuara/diplomuar në studimet e lidhura me TIK kundrejt rezultateve të karrierës në industrinë e TIK	13
Figura 4: Vetëbesimi në aftësitë digjitale midis vajzave dhe djemve në vendet e BE-së	15
Figura 5: Përqindja e të anketuarave/anketuarve gra dhe burra që kanë përdorur internetin "gjatë tre muajve të fundit"	16
Kutia 1: Treguesit kryesorë të BE-së për fushën përkatëse të politikave, që është e mundur të llogariten në Shqipëri	17
Kutia 2: Përmbledhje e çështjeve kryesore të pabarazive gjinore në digjitalizim dhe në TIK	18
Tabela 1: Përfitimet e trajtimit të objektivave të barazisë gjinore në agjendën digjitale dhe në TIK	20
Tabela 2: Përafrimi i Kapitullit 20 dhe i Kapitullit 25 me treguesit e GAP III të BE-së	27
Tabela 3: Kërkesat minimale për përmbushjen e kriterëve të Kategorisë 1 të vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të DAC të OECD-së	32
Tabela 4: Veprime prioritare për integrimin e objektivave të barazisë gjinore në politikat e digjitalizimit dhe në TIK	44

SHKURTESA DHE AKRONIME

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AFP	Anketa e Forcave të Punës
ASAP	Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna
BE	Bashkimi Evropian
BPfA	Platforma për Veprim e Pekinit
BPGJ	Buxheti i Përgjigjshëm Gjnor
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
COVID-19	Sindroma e rëndë akute e rrugëve të frymëmarrjes shkaktuar nga koronavirusi 2 (SARS-CoV-2)
DHnGV	Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
EIGE	Instituti Evropian për Barazinë Gjinore
Eurostat	Zyra e Statistikave e Bashkimit Evropian
EU4GE	BE për Barazinë Gjinore
GAP	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (i BE-së)
GENDERNET	Rrjeti për Barazi Gjinore i Komitetit të Ndihmës për Zhvillim, i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD DAC)
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para - Anëtarësimit
ITU	Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
KE	Komisioni Evropian
KM	Këshilli i Ministrave
KR-IPJ	Korniza e Rezultateve e Instrumenteve të Politikës së Jashtme (të BE-së)
NDICI	Instrumenti i Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OECD-DAC	Komiteti i Ndihmës për Zhvillim i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OZHQ	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
PPB	Prodhimi i Përgjithshëm Bruto

PPPGJ	Prokurim Publik i Përgjigjshëm Gjinator
SANECA	Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit të Shqipërisë për Kapitujt Ekonomikë të Acquis
SKBCJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjimore
SHTIM	Shkenca, Teknologjia, Inxhinieria dhe Matematika
TBE	Traktati i Bashkimit Evropian
TFBE	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
TI	Teknologjia e Informacionit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UN	Kombet e Bashkuara
UN SCR 1325	Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 'Gratë, Paqja dhe Siguria'
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjimore dhe Fuqizimin e Grave
US\$	Dollar Amerikan

HYRJE

Ky udhëzues për integrimin gjinor është pjesë e një vargu materialesh burimore që i janë vënë në dispozicion qeverisë së Shqipërisë përmes ndihmës teknike të BE-së dhe UN Women, me qëllim përshpejtimin e procesit të integritimit në BE. Qëllimi i tij është të sigurojë që dokumentet e ardhshme të politikave, planifikimit dhe programimit të përafrohen ngushtë me kuadrin ligjor dhe të politikave të BE-së për barazinë gjinore ('*acquis* për barazinë gjinore'), çka do të sjellë përmirësimin e rezultateve të barazisë për të gjitha/gjithë: gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në mbarë vendin. Ai u drejtohet partnerëve të zhvillimit dhe integritimit të përfshirë në nisma të politikave, programimit dhe planifikimit, në kontekstin e anëtarësimit në BE. Në këtë grup përfshihen së pari nëpunëset/nëpunësit që formulojnë politikën dhe hartojnë programet e IPA-s, ekspertet/ekspertët që ofrojnë ndihmë teknike, drejtueset/drejtuesit e projekteve pranë Delegacionit të BE-së, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit që mbështesin reformën e përafrimit me BE-në dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të angazhuara në proceset e llogaridhënies dhe konsultimit. Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të ofrojë informacion të përmbledhur mbi çështje gjinore kryesore në një fushë të caktuar të politikave dhe të tregojë se si mund të realizohet integrimi gjinor në terma praktikë. Udhëzuesi është parashikuar si një material përgatitor për hedhjen e bazave në këtë drejtim. Ai mund të përdoret nga individët si dokument orientues në punën e tyre të përditshme dhe shërben si material trajnimi në përpjekjet për të krijuar kapacitete dhe aftësi për integrimin gjinor.

Barazia ndërmjet grave dhe burrave është një parim themelor i Bashkimit Evropian. E drejta e grave për trajtim të barabartë është, para së gjithash, një nga të drejtat themelore të njeriut. Legjislacioni i BE-së, e njeh diskriminimin si të papranueshëm politikisht, pa përfitim ekonomik, dhe të dënueshëm me ligj. Për këtë arsye, shteteve u kërkohet që të përmbushin kërkesat e *acquis* për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. Siç përcaktohet në legjislacionin e BE-së, strategjia për promovimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave dhe luftimin e diskriminimit është integrimi gjinor. Rrjedhimisht, integrimi gjinor është parakusht për përafrimin e standardeve kombëtare me parimet e BE-së dhe një element i pandashëm i proceseve vijuese të reformës.

Teknologjia digjitale ka rëndësi thelbësore në jetën e njerëzve, me mbi 90 për qind të vendeve të punës në të gjithë botën që kanë një komponent digjital dhe që shumë shpejt, në shumë prej tyre, do të kërkohen aftësi digjitale të sofistikuar.¹ Strategjia e BE-së 'Busulla Digjitale 2030' është një strategji që

1 Plan International, 'Bridging the Gender Digital Divide' [Online]. ('Eliminimi i dallimeve gjinore në fushën digjitale') [në internet]. Shih: <https://plan-international.org/quality-education/bridging-the-digital-divide/>, cituar në ITU dhe UN WOMEN (2021), *Digitally Empowered Generation Equality: Women, Girls and ICT in the Context of Covid-19 in Selected Western Balkan and Eastern Partnership Countries*, (Fuqizimi digjital i brezit të barazisë: gratë, vajzat dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit në kontekstin e Covid-19 në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe të Partneritetit të Lindjes), shih: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/3/digitally-empowered-generation-equality-women-girls-and-ict-in-the-context-of-covid-19>

synon të sigurojë përdorimin e barabartë të teknologjive digjitale nga të gjitha/ gjithë qytetaret/qytetarët për të nxitur një rritje ekonomike të qëndrueshme, si dhe për të trajtuar në të njëjtën kohë edhe sfidat sociale.² Në strategji përmenden shprehimisht pabarazitë midis grave dhe burrave sa i takon përfitimeve nga hapësira digjitale dhe aksesit të tyre në shërbimet digjitale ('hendeku gjinor digjital') dhe synohet konvergimi i tyre.

Të drejtat sociale dhe ekonomike, të drejtat qytetare dhe fuqizimi i grave në shekullin e 21-të nuk mund të realizohen pa angazhimin e barabartë dhe të njëmendtë të grave në fushën e digjitalizimit dhe në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).³ Për këtë qëllim, përfshirja e objektivave të barazisë gjinore në sektorin digjital është me rëndësi thelbësore për të eliminuar hendekun gjinor, duke krijuar kushte të favorshme dhe duke rritur pjesëmarrjen e grave dhe të vajzave në ekonominë dhe shoqërinë digjitale".⁴ Ky udhëzues për integrimin gjinor në fushat e digjitalizimit dhe të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, i ndihmon palët e interesuara:

- të kuptojnë problemet e pabarazisë gjinore në fushën e digjitalizimit dhe në TIK;
- të njihen me rekomandimet e politikave dhe direktivat përkatëse të BE-së;
- të identifikojnë treguesit përkatës për integrimin gjinor në agjendën digjitale dhe në sektorin TIK;
- të njohin metodat dhe mjetet e standardizuara të BE-së për përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore;
- të angazhohen në veprimtari të mëtejshme konkrete, bazuar në një listë të përmbledhur rekomandimesh kryesore.

2 Komisioni Evropian (2021). KOMUNIKATË E KOMISIONIT DREJTUAR PARLAMENTIT EVROPIAN, KËSHILLIT, KOMITETIT EKONOMIK DHE SOCIAL DHE KOMITETIT TË RAJONEVE. COM(2021) 118 final. *2030 Digital Compass: the European way for the Digital Decade*. (Busulla digjitale 2030: rruga evropiane në dhjetëvjeçarin digjital). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A52021DC0118>

3 ITU dhe UN WOMEN (2016). *Action Plan to Close the Digital Gender Gap*. (Plan veprimi për eliminimin e hendekut gjinor digjital). Gjetet në: <https://www.itu.int/en/action/gender-equality/Documents/ActionPlan.pdf>

4 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2017). *Gender and Digital Agenda*. (Cjnia dhe agjenda digjitale). Shih: https://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/ti_pubpdf_mh0216896enn_pdfweb_20170124121443.pdf, f.8.

Barazia gjinore nuk ka të bëjë vetëm me 'gratë'.

Përkundrazi, ajo ka të bëjë me realitetet dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në të gjithë shoqërinë; dhe me pranimin që këto realitete dhe nevoja duhet të vlerësohen dhe – çka është e rëndësishme – të edukohen.

Për këtë është e nevojshme të sigurohet që të gjithë njerëzit të fuqizohen që të luajnë një rol të plotë dhe produktiv në familje, komunitet, shoqëri dhe ekonomi. Të jenë vetë zot të jetës së tyre, të bëjnë zgjedhjet që dëshirojnë dhe, për rrjedhojë, të kenë akses të drejtë dhe të barabartë në shërbime, mbështetje dhe në mundësi.

Prandaj, qeverisja e përgjigjshme gjinore ka të bëjë me sigurimin që, në të gjitha politikat, programet, aktivitetet, përparësitë dhe buxhetet e përgatitura prej saj, qeveria mban parasysh nevojat dhe shqetësimet e ndryshme të grave dhe burrave, si dhe trajton dhe redukton pabarazitë ndërmjet tyre.

“Sot, në të gjithë botën, numri i grave që kanë telefona inteligjentë dhe mund të përdorin internetin përmes rrjetit celular është rreth 327 milion më pak se numri i burrave. Gratë janë të nënpërfaqësuar në vendet e punës në sektorin TIK, në poste drejtuese dhe në karriera akademike dhe burrat kanë katër herë më shumë gjasa se gratë të jenë specialistë në TIK. Në moshën 15 vjeçare, mesatarisht vetëm 0,5% e vajzave shprehin dëshirën për të punuar në fushën e TIK, krahasuar me 5% të djemve.

Kompanitë e reja të sapokrijura me pronare gra marrin 23% më pak fonde dhe kanë 30% më pak gjasa që të dalin nga tregu me bilanc pozitiv, krahasuar me bizneset me pronarë burra. [...]

Teknologjitë digjitale ofrojnë mundësi të reja për të përparuar, por zgjidhjet teknologjike nuk mund të ndreqin problemet strukturore bazë që janë shkas i hendekut gjinor digjital. [...]

Ekziston nevoja për veprime politike konkrete për nxitjen e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes së plotë të grave dhe vajzave në ekonominë digjitale, duke trajtuar në të njëjtën kohë edhe stereotipet dhe normat gjinore që çojnë në diskriminimin e grave. Problemi i hendekut gjinor digjital duhet të zgjidhet. [...]

Nuk ka asnjë arsye pse gratë të mbeten mbrapa në fushën e transformimit digjital. Ngushtimi dhe eliminimi i hendekut gjinor, edhe në botën digjitale, mund të sigurojë burime të reja për rritjen ekonomike në shkallë globale, të mbështesë zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe të ndihmojë në arritjen e [...] synimit për një rritje ekonomike të fuqishme, të qëndrueshme dhe përfshirëse.”

Burimi: OECD (2018). *Bridging the digital gender divide: include, upskill, innovate*. (Eliminimi i hendekut gjinor digjital: përfshirje, rritje e aftësive, novacion). Shih: <https://www.oecd.org/digital/bridging-the-digital-gender-divide.pdf>

1 DIGJITALIZIMI DHE TIK – ÇËSHTJET GJINORE KRYESORE NË SHQIPËRI

Sipas të dhënave të fundit të ITU-së (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit), në vitin 2020, interneti u përdor nga 72,2 për qind e popullsisë në Shqipëri. Ky rezultat është nën mesataren e rajonit të Evropës prej 84,9 për qind. Numri i përdorueseve/përdoruesve të internetit po shtohet vazhdimisht, me një rritje vjetore prej 3,3 pikë përqindjeje gjatë tre viteve të fundit.⁵ Ndonëse lidhshmëria në rrjete është shtylla qendrore e transformimit digjital, është me rëndësi thelbësore që ky transformim digjital të ketë në qendër njerëzit, për të siguruar jo vetëm që të gjitha/gjithë anëtarët/anëtarët e shoqërisë të jenë të lidhur digjitalisht, por edhe që lidhja e tyre të jetë domethënëse dhe efektive dhe t'u mundësojë të kenë akses dhe të gëzojnë plotësisht të gjitha të mirat e një bote digjitale në rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm. Megjithatë, aktualisht të mirat e transformimit digjital nuk gëzohen në mënyrë të barabartë nga të gjitha gratë dhe të gjithë burrat, e as nga të gjitha grupet shoqërore. Aksesit, përdorimi dhe zotërimi i pajisjeve dhe mjeteve digjitale ndjekin modelet gjinore. Termi 'hendeku gjinor digjital' i referohet pabarazive ndërmjet grave/vajzave dhe burrave/djemve për sa u përket burimeve, aftësive dhe mundësive për të pasur akses dhe për të përdorur teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në mënyrë efektive.⁶ Në këtë pjesë paraqitet një tablo e përgjithshme e çështjeve kryesore lidhur me pabarazitë gjinore në fushën e politikave, të cilat duhen trajtuar.

Dy të tretat e studenteve/studentëve në arsimin e lartë janë vajza, por numri i vajzave që ndjekin studimet në degë që lidhen me teknologjinë është shumë i ulët. Degët e studimit në arsimin e lartë vazhdojnë të jenë mjaft të ndara sipas gjinive. Pavarësisht nga numri shumë më i madh i vajzave (59,3 për qind) se sa i djemve (40,7 për qind) në arsimin e lartë, vajzat janë më të përfaqësuara në degët e shkencave shoqërore se sa në fushat e shkencave natyrore.⁷ Në arsimin e lartë, vetëm 4,7 për qind e studenteve të regjistruara ndjekin studime në fusha që lidhen me TIK, krahasuar me 11,9 për qind të studentëve të regjistruar.⁸ Përqindja e studenteve të TIK-ut nuk është rritur që nga viti 2018 dhe mbetet dukshëm nën mesataren e BE-së prej 17 për qind.⁹ Stereotipet gjinore social-

5 ITU (2022). *Digital Development Country Profile – Albania*. (Profili i zhvillimit digjital – Shqipëria). Shih: https://www.itu.int/en/ITU-D/Regional-Presence/Europe/Documents/Publications/2022/Digital%20Development/Digital%20Development%20Country%20Profile_Albania_final_02.22.pdf

6 UN Women (2005) cituar në OECD (2018). *Bridging the digital gender divide: include, upskill, innovate*. (Eliminimi i hendekut gjinor digjital: përfshirje, rritje e aftësive, novacion). Shih: <https://www.oecd.org/digital/bridging-the-digital-gender-divide.pdf>

7 INSTAT (2022). *Burra dhe Gra në Shqipëri 2022*, f.60. Gjendet në: <https://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf>


8 Të dhëna të siguruar nga INSTAT mbi 'Studente/Studentë të regjistruara/regjistruar në fushën e studimit TIK (2018-2022)', gjeneruar nëpërmjet bazës së të dhënave statistikore të INSTAT në formatin PC-Axis.

9 Eurostat (2020). *Girls and women among ICT students: what do we know?* (Vajzat dhe gratë në mesin e studenteve/studentëve të TIK: çfarë dimë ne?). Shih: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/edn-20200423-1>

kulturore vazhdojnë t'i etiketojnë vajzat si të përshtatshme për vende pune që konsiderohen 'punë përkujdesi', si mësimdhënia, infermiera, apo puna sociale, gjë që ka ndikim frenues për vajzat që duan të ndjekin studimet në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (SHTIM). Megjithatë, punësimi në vende pune që lidhen me shkencën dhe teknologjinë do t'u ofronte grave akses më të barabartë në vende pune me paga më të larta.

FIGURA 1


Pjesëmarrja e vajzave dhe djemve në arsimin e lartë



Burimi: INSTAT (2022), Burra dhe Gra në Shqipëri 2022.

FIGURA 2

Pjesëmarrja e vajzave dhe djemve në studime të lidhura me TIK-un



Burimi: Të dhënat e siguruar nga INSTAT për 'Studentet/Studentët e regjistruara/regjistruar në fushën e studimit TIK (2018-2022)'; dhe Eurostat (2020), *Girls and women among ICT students: what do we know?* (Vajzat dhe gratë midis studenteve/studentëve të TIK: çfarë dimë ne?).

Ndarja gjinore në arsim pasqyrohet edhe në tregun e punës. Orientimi i vajzave drejt fushave të studimit që konsiderohen më 'femërore' çon në një mungesë të theksuar të modeleve dhe shembujve pozitivë të vajzave e grave në fushat studimi si SHTIM dhe TIK. Përveç kësaj, mungesa e grave në shkencë dhe teknologji përforcon pikëpamjet e njëanshme gjinore për feminilitetin dhe maskulinitetin dhe për rolet e grave dhe të burrave në shoqëri. Me gjithë kërkesat e mëdha për profesioniste/profesionistë në fushën digjitale, numri i grave që aplikojnë për këto vende pune është shumë i ulët.

Ndonëse një pjesë e madhe e studenteve/studentëve që diplomohen në degë që lidhen me TIK janë gra, shumica dërrmuese e posteve drejtuese në këtë sektor mbahet nga burrat. Në vitin 2020, gratë përbënin më se 40 për qind të studenteve/studentëve të diplomuar në fushat e SHTIM-it.¹⁰ Në mënyrë të ngjashme, shifrat për vitin 2022 flasin për një numër relativisht të lartë të grave të diplomuara në TIK: përkatësisht 41,8 për qind gra dhe 58,2 për qind burra.¹¹ Megjithatë, për gratë e diplomuara në TIK, arritja arsimore nuk rezulton domosdoshmërisht në mundësi punësimi dhe zhvillimi të karrierës në këtë sektor: numri i grave në poste drejtuese në degët TIK të ekonomisë, si për shembull në nivel menaxhereje ose drejtoreshë, është krahasimisht shumë i ulët, 26 për qind.¹² Përveç praktikave të njëanshme të rekrutimit, të dhënat tregojnë për ekzistencën e një 'tavani të qelqtë', që i referohet pengesave dhe barrierave të padukshme të cilat pengojnë aktivisht aksesin e grave në postet e larta vendimmarrëse dhe drejtuese në organizata.


10 ITU dhe UN WOMEN (2021). *Digitally Empowered Generation Equality: Women, Girls and ICT in the Context of Covid-19 in Selected Western Balkan and Eastern Partnership Countries*. (Fuqizimi digjital i brezit të barazisë: gratë, vajzat dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit në kontekstin e Covid-19 në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe të Partneritetit të Lindjes). Shih: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/3/digitally-empowered-generation-equality-women-girls-and-ict-in-the-context-of-covid-19>, f.3.

11 Të dhënat e INSTAT 'Studente/Studentë të diplomuara/diplomuar në fushën e studimit TIK sipas nivelit të programit, 2022'.

12 Llogaritje të INSTAT-it mbi 'Kontribuese/Kontribues të punësuar/punësuar si menaxhere/ menaxherë ose drejtore/drejtorë të nivelit të lartë në sektorët e TIK në 2020 dhe 2021', bazuar në të dhënat për 'Kontribueset/Kontribuesit e sigurimeve shoqërore' të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

FIGURA 3

Përqindja e grave dhe burrave të diplomuara/diplomuar në studimet e lidhura me TIK kundrejt rezultateve të karrierës në industrinë e TIK



Burimi: Të dhënat e INSTAT.

Kultura e punës në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, që dominohet nga burrat, përbën një barrierë të rëndësishme për hyrjen, qëndrimin dhe përparimin e grave në vendet e punës në këtë sektor. Përveç faktit që gratë bartin pjesën më të madhe të përgjegjësiave dhe detyrimeve të perkujdesit në familje, ato përballen edhe me një varg vështirësish, që nga “të ndjerët e izoluar” deri tek “bërja objekt i komenteve me natyrë seksuale që të ulin vlerën si profesioniste”. Sikurse u shpreh edhe një ish-menaxhere në sektorin e TI-së, në Shqipëri “grave u duhet të punojnë sa dyfishi i burrave për t’u marrë seriozisht dhe për t’u respektuar”¹³, duke e rënduar edhe më shumë trysninë e ushtruar mbi gratë në këtë sektor. Si rezultat, përfaqësimi i grave – veçanërisht në vende pune me cilësi dhe në poste drejtuese të larta – mbetet i ulët.

Normat gjinore social-kulturore i pengojnë gratë dhe vajzat që të aftësohen në fushat teknike, si dhe pengojnë aksesin dhe përdorimin e pajisjeve digjitale prej tyre. Sipas disa normave gjinore, shkencat kompjuterike “nuk janë degë të përshtatshme për vajzat”; ose vajzat që

13 ITU dhe UN WOMEN (2021). *Digitally Empowered Generation Equality: Women, Girls and ICT in the Context of Covid-19 in Selected Western Balkan and Eastern Partnership Countries*. (Fuqizimi digjital i brezit të barazisë: gratë, vajzat dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit në kontekstin e Covid-19 në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe të Partneritetit të Lindjes). Shih: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/3/digitally-empowered-generation-equality-women-girls-and-ict-in-the-context-of-covid-19>

janë të afta në matematikë dhe shkencë “mendojnë si djem”.¹⁴ Në hapësirat digjitale, normat tradicionale të feminitetit dhe maskulinitetit bëhen edhe më të theksuara, gjë që ka pasoja për mënyrat e përdorimit të internetit nga të rejtat dhe të rinjtë.¹⁵ Sidomos për sa u përket grave dhe vajzave, kjo ka bërë që platformat digjitale të jenë hapësira ku ato vetëmonitorohen dhe përpiqen t’u përmbahen modeleve gjinore dhe standardeve të vendosura nga burrat (si për shembull, të jesh e bukur, elegante, e re, tërheqëse), ndërsa djemtë e rinj janë vazhdimisht të ekspozuar ndaj mediave që i trajtojnë gratë si objekte dhe tolerojnë agresivitetin ndaj tyre. Po kështu, ndaj djemve të rinj imazhi i të cilëve nuk përputhet me idealin e maskulinitetit tradicional që promovohet në internet, ushtrohet trysni dhe ata rrezikojnë të bëhen objekt i talljeve të shokëve të tyre.¹⁶ Përveç kësaj, digjitalizimi ndikon në formimin e pikëpamjeve dhe sjelljeve të adoleshenteve dhe adoleshentëve lidhur me marrëdhëniet seksuale dhe me mënyrat se si duhet të ndërveprojnë të rejtat e të rinjtë mes tyre. Për shembull, ka raste të shumta kur vajzat kërcënohen me ndarje ose me dhunë fizike nëse refuzojnë të dërgojnë foto të tyre, të zhveshura.¹⁷

Normat dhe paragjykimet gjinore ndikojnë negativisht në vetëbesimin e vajzave lidhur me aftësitë e tyre në TI. Të dhëna nga BE-ja tregojnë se më shumë se nëntë nga dhjetë vajza dhe djem të moshës 16-24 vjeç kanë aftësi të mjaftueshme për të përdorur teknologjitë digjitale në jetën e tyre të përditshme. Megjithatë, djemtë tregojnë shumë më tepër vetëbesim në aftësitë e tyre digjitale krahasuar me vajzat.¹⁸

14 *Po aty.*

15 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2018). *Gender Equality and Youth: Opportunities and Risks of Digitalisation*. (Barazia gjinore dhe rinia: mundësitë dhe rreziqet e digjitalizimit). Shih: <https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/gender-equality-and-youth-opportunities-and-risks-digitalisation>


16 *Po aty.*

17 *Po aty.*

18 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2018). *Gender Equality and Digitalisation in the European Union*. (Barazia gjinore dhe digjitalizimi në Bashkimin Evropian). Gjetet në: <https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/gender-equality-and-digitalisation-european-union>

FIGURA 4

Vetëbesimi në aftësitë digjitale midis vajzave dhe djemve në vendet e BE-së



Burimi: Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2018), *Gender Equality and Digitalisation in the European Union*. (Barazia gjinore dhe dixhitalizimi në Bashkimin Evropian).

Ngacmimet në internet dhe jashtë tij pengojnë pjesëmarrjen e plotë të grave dhe vajzave.¹⁹ Dhuna digjitale ndaj grave dhe vajzave (DHnGV) është e përhapur kudo. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe i digjitalizimit u ka krijuar mundësi keqberësve kibernetikë që të keqtrajtojnë, ngacmojnë dhe lëndojnë gratë përmes abuzimit të këtyre teknologjive.²⁰ Në një anketim të BE-së me të reja dhe të rinj të moshës 15-vjeçare, u konstatua se përqindja e vajzave që kishin përjetuar ngacmim dhe agresion/bullizëm në internet të paktën një herë ishte mjaft e lartë (12 për qind), krahasuar me shtatë për qind të djemve.²¹ Pjesa më e madhe e akteve të dhunës mbeten të padokumentuara dhe të pakontrolluara, dhe agresioni në internet po pranohet gjithnjë e më shumë si një sjellje 'normale'. Si mënyrë për t'u vetëmbrojtur, vajzat dhe gratë e reja në veçanti, frenohen në atë që shprehin në internet ose edhe tërhiqen plotësisht prej tij, për arsye të frikës nga "agresioni kibernetik, bullizmi me natyrë seksuale në internet, thashethemet dhe komentet me urrejtje".²²

19 ITU dhe UN WOMEN (2021). *Digitally Empowered Generation Equality: Women, Girls and ICT in the Context of Covid-19 in Selected Western Balkan and Eastern Partnership Countries*. (Fuqizimi digjital i brezit të barazisë: gratë, vajzat dhe TIK në kontekstin e Covid-19 në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe të Partneritetit të Lindjes). Shih: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/3/digitally-empowered-generation-equality-women-girls-and-ict-in-the-context-of-covid-19>, f.3.

20 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2017). *Gender and Digital Agenda*. (Gjinia dhe agjenda digjitale). Gjendet në: <https://eige.europa.eu/publications/gender-and-digital-agenda>


21 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2018). *Gender Equality and Digitalisation in the European Union*. (Barazia gjinore dhe digjitalizimi në Bashkimin Evropian). Shih: <https://eige.europa.eu/publications/gender-equality-and-digitalisation-european-union>

22 *Po aty*, f.3.

Numri i grave që përdorin internetin është në rritje, por hendeku gjinor vazhdon të ekzistojë për sa i përket përdorimeve më komplekse të internetit. Gjatë periudhës 2018-2020, numri i grave dhe burrave që e kishin përdorur internetin “gjatë tre muajve të fundit” u rrit shumë në Shqipëri. Ky ndryshim ishte sidomos i theksuar ndër gratë, me një rritje prej 12,2 pikë përqindjeje, që është pothuaj sa dyfishi i rritjes së përdorimit të internetit nga burrat, me 6,9 pikë përqindjeje.²³ Që atëherë, trendi është niveluar dhe deri në vitin 2022, 81,7 për qind e grave dhe 83,5 për qind e burrave e kishin përdorur internetin “gjatë tre muajve të fundit”.²⁴ Megjithatë, në përgjithësi konstatohet se burrat e përdorin më shumë se gratë internetin për të pasur akses në aplikacione, burime dhe shërbime, si për shembull për shkarkimin e programeve kompjuterike dhe për kryerjen e veprimeve bankare në internet.²⁵

FIGURA 5

Përqindja e të anketuarave/anketuarve gra dhe burra që kanë përdorur internetin “gjatë tre muajve të fundit”



Burimi: INSTAT (2021, 2023), Anketa mbi 'Përdorimin e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në familje dhe nga individët'.

23 INSTAT (2021). Anketa mbi 'Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në familje dhe nga individët' në vitin 2020. Gjendet në: <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt/#tab2>

24 INSTAT (2023). Anketa mbi 'Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në familje dhe nga individët' në vitin 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/media/11157/ict-2022_shqip.pdf

25 Eurostat, Statistikat e shpjeguara [Në internet]. *Digital economy and society statistics – households and individuals*. (Statistikat e ekonomisë dhe shoqërisë digjitale – familjet dhe individët). Shih: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Digital_economy_and_society_statistics_-_households_and_individuals, cituar nga Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2016), *Gender and Digital Agenda*, (Gjinia dhe agenda digjitale), shih: <https://eige.europa.eu/publications/gender-and-digital-agenda>

Shumë gra dhe vajza kanë telefona celularë, por vazhdojnë të ekzistojnë kufizimet në përdorimin e pavarur të tyre. Një përqindje e madhe e grave dhe burrave të moshës 15-59 vjeç zotërojnë telefona celularë (përkatësisht, 89 dhe 94 për qind).²⁶ Megjithatë, të dhënat tregojnë se edhe para situatës së shkaktuar nga pandemia e Covid-19 (izolimit në shtëpi), përdorimi i telefonave celularë nga gratë dhe vajzat shpesh kontrollohej nga anëtarët burra/djem të familjes.²⁷

Mungesa e të dhënave gjinore mbi digjitalizimin dhe TIK pengojnë trajtimin e pabarazive dhe të sfidave gjinore specifike. Të dhënat e ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore kanë rëndësi thelbësore për të kuptuar situatën e grave dhe burrave në këtë sektor. Ato janë gjithashtu shumë të rëndësishme për kryerjen e analizave gjinore, hartimin e politikave të përgjigjshme gjinore dhe të masave që trajtojnë pabarazitë dhe sfidat gjinore specifike. Në parim, është e mundur të llogariten disa tregues kryesorë (gjinorë) të BE-së për digjitalizimin dhe TIK në Shqipëri, mbështetur në të dhënat administrative ekzistuese. (Shih Kutia 1).

KUTIA 1

Treguesit kryesorë të BE-së për fushën përkatëse të politikave, që është e mundur të llogariten në Shqipëri

- Përqindja e familjeve që kanë akses në kompjuter në shtëpi
- Përdorimi dhe akses në kompjuter i anëtareve/anëtarëve të familjeve nga zona të ndryshme gjeografike dhe segmente të ndryshme social-ekonomike të popullsisë
- Dallimet ndërmjet aftësive digjitale të vajzave/grave dhe djemve/burrave (hendeku gjinor i aftësive)
- Numri i studenteve/studentëve të diplomuara/diplomuar në degët SHTIM, i ndarë sipas seksit
- Të dhëna për punësimin në fushat SHTIM/TIK, të ndara sipas seksit
- Akses në shërbime dhe transaksione bazë në internet, ndarë sipas seksit
- Përqindja e individëve që përdorin internetin për t'u lidhur me autoritetet publike në 12 muajt e fundit, ndarë sipas seksit

26 INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF (2018). *Albania Demographic and Health Survey 2017-18*. (Studimi Demografik dhe Shëndetësor për Shqipërinë 2017-2018). Gjendet (në gjuhën angleze) në: <http://www.instat.gov.al/media/5050/adhs-2017-18-pdf.pdf>

27 INSTAT (2020). Anketa mbi 'Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në familje dhe nga individët'. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/media/8267/ict-2020_shqip_.pdf

Për përcaktimin e këtyre treguesve është parakusht ekzistenca e një koordinimi më të mirë midis institucioneve. Të dhënat që kërkohen për të bërë llogaritjet mund të nxirren nga anketat vjetore të buxhetit të familjes që kryen INSTAT-i, nga portali qeveritar 'E-Albania', dhe përmes Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA). Të dhënat për dallimet gjinore në aftësitë digjitale të popullsisë shqiptare mund të nxirren përmes shkëmbimit sistematik të të dhënave ndërmjet dy institucioneve të sipërpërmendura dhe INSTAT-it. Gjithashtu, të dhënat gjinore nga vrojtime për rezultatet e punësimit në fushat SHTIM dhe TIK, përfshirë edhe ato për sipërmarrjet digjitale, mund të merren nga Anketa e Forcave të Punës (AFP) dhe nga Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna (ASAP).

KUTIA 2

Përmbledhje e çështjeve kryesore të pabarazive gjinore në digjitalizim dhe në TIK

- Akses dhe përdorim i pabarabartë i teknologjive digjitale ndër gratë/vajzat dhe burrat/djemtë.
- Ndarja gjinore në fushat e studimit – vajzat kanë më pak gjasa të ndjekin studime në fushat që lidhen me teknologjinë (SHTIM, TIK) krahasuar me djemtë.
- Pjesëmarrja e ulët e grave në tregun digjital të punës – numri i grave që fitojnë jetesën dhe bëjnë karrierë në TIK është më i vogël.
- Dhuna ndaj grave, bullizmi dhe ngacmimi në internet, si dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore pengojnë pjesëmarrjen e grave dhe vajzave.
- Përforcimi i roleve të pabarabarta gjinore dhe promovimi i normave të dëmshme gjinore në internet.
- Mungesat në të dhënat administrative e statistikave gjinore dhe të dhënave të ndara sipas seksit, si dhe mungesa e koordinimit ndër-institucional për përcaktimin e treguesve gjinorë kryesorë.

2 BARAZIA GJINORE DHE AGJENDA DIGJITALE NË KONTEKSTIN E ANËTARËSIMIT NË BE

Në BE, sektori digjital është përgjegjësi si e Komisionit Evropian ashtu edhe e shteteve anëtare të BE-së. Shtetet anëtare janë përgjegjëse për krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e ekonomisë digjitale, që përfshin pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në ekonominë dhe shoqërinë digjitale. Komisioni ka përgjegjësinë që të krijojë Tregun e Përbashkët Digjital, një nga dhjetë prioritetet politike të BE-së. Ai përkufizohet si tregu për lëvizjen e lirë të njerëzve, shërbimeve dhe kapitalit, ku individët dhe bizneset mund të kenë akses dhe të kryejnë veprimtari digjitale në internet në kushtet e konkurrencës së drejtë dhe me një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatoreve/konsumatorëve dhe të të dhënave personale, pavarësisht nga shtetësia apo vendi i banimit. Maksimizimi i potencialit për rritje të ekonomisë digjitale është një nga shtyllat e strategjisë së Tregut të Përbashkët Digjital. Për këtë arsye, Komisioni Evropian ka ndërmarrë veprime për t'i nxitur shtetet anëtare të BE-së që të përshpejtojnë zhvillimin e ekonomisë digjitale, ndër to edhe nismën për mbështetjen e shteteve anëtare në përmirësimin e aftësive digjitale dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në këtë sektor. Vlerësohet se aksesit i 600 milion grave dhe vajzave të tjera në internet në shkallë globale do shoqërohet me një rritje të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PPB) me deri në 18 miliardë US\$.²⁸

Konsideratat në lidhje me barazinë gjinore luajnë rol kryesor në përcaktimin e drejtimeve strategjike në këtë sektor. Ato përcaktojnë se kush mund të përfshihet në marrjen e vendimeve në lidhje me botën digjitale; ato ndikojnë në shkallën e aksesit të grave/vajzave dhe burrave/djemve në pajisjet digjitale; si dhe përcaktojnë se kush mund të aftësohet dhe do të ketë mundësi të marrë pjesë në ekonominë digjitale dhe, rrjedhimisht, të përfitojë nga një hapësirë digjitale e pasur, e aksesueshme dhe e sigurtë, me një gamë të plotë shërbimesh. Eliminimi i hendekut gjinor digjital është me rëndësi të jashtëzakonshme që gratë të fitojnë të ardhura, të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në proceset qeverisëse, të kontribuojnë me novacione dhe t'i japin formë së ardhmes. Kjo mund të arrihet duke rritur aksesin e grave në internet dhe në mjete digjitale, duke u krijuar grave dhe vajzave më shumë mundësi për të studiuar në degët e TIK dhe duke rritur pjesëmarrjen e tyre në ekonominë digjitale.²⁹ Trajtimi i objektivave të barazisë gjinore në agjendën digjitale dhe TIK ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike dhe në zhvillimin shoqëror në mënyrat e mëposhtme:

28 United Nations Broadband Commission (2013). *Doubling Digital Opportunities: Enhancing the Inclusion of Women and Girls in the Information Society*. (Dyfishimi i mundësive digjitale: rritja e përfshirjes së grave dhe vajzave në shoqërinë e informacionit). Shih: <https://www.broadbandcommission.org/Documents/publications/bb-doubling-digital-2013.pdf>

29 Po aty.

TABELA 1

Përfitimet e trajtimit të objektivave të barazisë gjinore në agjendën digjitale dhe në TIK³⁰

Rritja ekonomike	Zhvillimi shoqëror
<ul style="list-style-type: none"> Aksesi në <i>broadband</i> forcon ekonominë e dijes, që bazohet në burimet intelektuale dhe ekspertizën e grave dhe të burrave, dhe qëndron në themel të zhvillimit në nivel kombëtar dhe të BE-së. Rritja e nivelit të punësimit të grave në sektorin TIK ndihmon në ngushtimin e hendekut gjinor në paga – ky është një prej sektorëve me paga më të larta dhe gratë që punojnë në TIK paguhen më mirë se gratë në profesione të tjera. Llogaritë bankare që mund të aksesohen përmes telefonit ofrojnë një mënyrë efektive për të rritur përfshirjen financiare të grave. Ngushtimi i hendekut gjinor në lëndët SHTIM do të çonte në rritje ekonomike, në krijimin e më shumë vendeve të punës (deri në 1,2 milion deri në vitin 2050), si dhe në rritjen e PPB-së në periudhën afatgjatë (deri në 820 miliard euro deri në vitin 2050). Përfshirja e më shumë grave në vende pune në TIK/sektorin digjital mund të ofrojë zgjidhje për problemin e mungesave të mëdha në forcat e punës në këtë sektor. 	<ul style="list-style-type: none"> Aksesi në teknologjinë moderne të informacionit dhe në internet mundëson aksesin në informacion dhe ushtrimin e të drejtave të njeriut (si p.sh., e drejta e shprehjes së lirë), si dhe nxit të drejtën për të marrë pjesë dhe për t'u përfshirë në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Përdorimi i TIK u mundëson grave të fitojnë aftësi të reja dhe kontribuon në punësimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të mjeteve të tyre të jetesës. TIK mund të ndihmojë për të përsheptuar realizimin e shërbimeve publike, duke mbështetur kështu pjesëmarrjen e grave në arsim dhe në shërbime të tjera publike. Aksesi në burime dhe shërbime prodhuese në internet zvogëlon varësinë e grave dhe vajzave nga ndërmjetësit apo persona të tretë. Vendet e punës digjitale ofrojnë mundësi për pasur një balancë më të mirë ndërmjet punës dhe jetës.

30 Bazuar në burimet e mëposhtme: Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2017), *Gender and Digital Agenda* (Gjinia dhe agjenda digjitale); Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2018), *Gender Equality and Digitalisation in the European Union* (Barazia gjinore dhe digjitalizimi në Bashkimin Evropian); OECD (2018), *Bridging the digital gender divide: include, upskill, innovate* (Eliminimi i hendekut gjinor digjital: përfshirje, rritje e aftësive, novacion); dhe ITU dhe UN WOMEN (2021), *Digitally Empowered Generation Equality: Women, Girls and ICT in the Context of Covid-19 in Selected Western Balkan and Eastern Partnership Countries* (Fuqizimi digjital i brezit të barazisë: gratë, vajzat dhe TIK në kontekstin e Covid-19 në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe të Partneritetit të Lindjes).

Në shumë vende të botës, teknologjia e informacionit dhe komunikimit po përdoret gjithnjë e më shumë për të promovuar barazinë gjinore dhe veçanërisht për të parandaluar dhe për të reaguar kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave (DHnGV). Për shembull, teknologjia e realitetit virtual po përdoret për të trajnuar punonjëset/punonjësit e rendit dhe të ligjit lidhur me kodet e sjelljes me ndjeshmëri gjinore. Në Shqipëri, Serbi dhe Malin e Zi janë krijuar dhe testuar aplikacione për telefona celularë (*apps*) në ndihmë të të mbijetuarave të dhunës në familje, që ato të kenë akses në informacion dhe në shërbime mbështetëse. Përveç ofrimit të informacioneve të dobishme, këto aplikacione mundësojnë edhe një mënyrë të menjëhershme, diskrete dhe konfidenciale për të kërkuar ndihmë – qoftë përmes kontaktimit të personave të besuar apo të linjave telefonike të ndihmës në nivel kombëtar ose vendor.³¹ Pra, edhe nga këndvështrimi i trajtimit të problemit të DHnGV-së, është e rëndësishme që të rritet pjesëmarrja e grave në botën digjitale dhe përdorimi prej tyre i funksioneve të shumëllojshme të teknologjive digjitale, me qëllim që ato të kenë akses në tërësinë e produkteve, shërbimeve dhe platformave të disponueshme.³²

31 ITU dhe UN WOMEN (2021). *Digitally Empowered Generation Equality: Women, Girls and ICT in the Context of Covid-19 in Selected Western Balkan and Eastern Partnership Countries*. (Fuqizimi digjital i brezit të barazisë: gratë, vajzat dhe TIK në kontekstin e Covid-19 në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe të Partneritetit të Lindjes). Shih: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/3/digitally-empowered-generation-equality-women-girls-and-ict-in-the-context-of-covid-19>

32 *Po aty*.

3 LIDHJA E DIGJITALIZIMIT DHE TIK ME ACQUIS E BE-SË PËR BARAZINË GJINORE

Integrimi gjinor është një strategji që synon përfshirjen e një **këndvështrimi gjinor** në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, strategjive, buxheteve, programeve të shpenzimeve, aktiviteteve të projekteve, masave rregullatore, funksioneve administrative dhe kulturës institucionale, me synim promovimin e **barazisë ndërmjet grave dhe burrave**, si dhe parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit.

Integrimi gjinor siguron që hartimi i politikave dhe puna legjislative të jenë të një cilësie më të lartë dhe që politikat t'u përgjigjen më me efektivitet nevojave të të gjitha/gjithë qytetareve/qytetarëve – gra dhe burra, vajza dhe djem. Me integrimin gjinor, ndërhyrjet publike bëhen më efektive dhe sigurojnë që pabarazitë të mos përsëriten në të ardhmen.

Objektivi kryesor i programeve të BE-së në vendet e (para)anëtarësimit është që shtetet candidate të mbështeten në punën për miratimin dhe zbatimin e të gjitha reformave (politike, institucionale, ligjore, administrative, shoqërore dhe ekonomike), të cilat kërkohet të jenë në përputhje me vlerat dhe të përafruara me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së. Kriteret e anëtarësimit (kriteret e Kopenhagës) përmbajnë parakushte të qarta për ekzistencën e institucioneve demokratike që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave.³³ Barazia gjinore – si një prej parimeve kryesore të shtetit ligjor – është pjesë përbërëse e pandarë e Strategjisë së Zgjerimit të BE-së.³⁴ Zgjerimi kërkon nga secili vend kandidat për anëtarësim që të miratojë të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta (*acquis* e BE-së), të cilat janë të detyrueshme për të gjitha vendet anëtare të BE-së.³⁵ Barazia gjinore është pjesë përbërëse e proceseve të anëtarësimit dhe të harmonizimit të legjislacionit, përmes zbatimit të këtyre parimeve që burojnë nga qasja e bazuar në të drejtat: (i) ligjshmëria, universaliteti dhe pandashmëria e të drejtave të njeriut; (ii) pjesëmarrja; (iii) mosdiskriminimi; (iv) llogaridhënia dhe përgjegjshmëria; dhe (v) transparencja në çdo hap të programimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të mbështetjes së BE-së.

33 Përfundimet e Presidencës së Këshillit Evropian, Kopenhagë, 21-22 qershor 1993. Gjetet në: <https://www.consilium.europa.eu/media/21225/72921.pdf>

34 Komisioni Evropian (2018). KOMUNIKATË E KOMISIONIT DREJTUAR PARLAMENTIT EVROPIAN, KËSHILLIT, KOMITETIT EKONOMIK DHE SOCIAL DHE KOMITETIT TË RAJONEVE. *A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, 2018, p.4.* (Një perspektivë e besueshme për zgjerimin dhe rritjen e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor, 2018, f.4). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52018DC0065>

35 EUR-Lex. *Glossary of Summaries [Online]*. (Listë tematike e përmbledhjeve) [në internet]. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/acquis.html>

Në nivelin e BE-së, detyrimi për t'u angazhuar për integrimin gjinor buron, ndër të tjera, nga:

- Traktati i Bashkimit Evropian (TBE);³⁶
- Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE)³⁷, nenet 8 dhe 10, ku përcaktohen detyrimet e BE-së dhe të shteteve anëtare për të siguruar përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në të gjitha veprimtaritë e BE-së;
- Direktiva 2004/113/EC e Këshillit e datës 13 dhjetor 2004³⁸, 'Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve';
- Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 5 korrik 2006³⁹ 'Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim' (Direktiva e rishikuar).

Gjithashtu, integrimi gjinor është i pasqyruar qartësisht në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së (2021-2025)⁴⁰ dhe është pjesë përbërëse e Rregulloreve të Instrumentit të Asistencës së Para - Anëtarësimit të BE-së (IPA III)⁴¹ – **për t'u anëtarësuar në BE, vendeve candidate u kërkohet që të përmbushin detyrimet e përcaktuara në *acquis* për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin.**

36 Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012M%2FTXT>

37 Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012E%2FTXT>

38 Direktivë e Këshillit Nr. 2004/113/EC e datës 13 dhjetor 2004, 'Implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services'. ('Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve'). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32004L0113>

39 DIREKTIVA 2006/54/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, e datës 5 korrik 2006, 'On the implementation of the principle of equal opportunities and equal treatment of men and women in matters of employment and occupation'. ('Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim') (Direktiva e rishikuar). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32006L0054>

40 Komunikatë e përbashkët e Parlamentit Evropian dhe Këshillit: Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III i BE-së – Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në veprimin e jashtëm të BE-së. Shih: https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/join-2020-17-final_en.pdf; GAP III i BE-së është plotësisht i harmonizuar me instrumentet ndërkombëtare, si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Platforma për Veprim e Pekinit (BPfA) dhe Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 'Gratë, paqja dhe siguria' (UNSCR 1325).

41 RREGULLORJA (BE) 2021/947 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale, ndryshon dhe shfuqizon Vendimin nr. 466/2014/EU dhe shfuqizon Rregulloren (BE) 2017/1601 dhe Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) Nr.480/2009. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R0947&from=EN>

Në nivel ndërkombëtar, Shqipëria është palë nënshkruese ose ka ratifikuar traktatet dhe instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare sipas të cilave vendi ka detyrimin të mbrojtë dhe të mbështesë të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, përfshirë:

- Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW të UN);⁴²
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit);⁴³
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BPfA);⁴⁴
- Rezolutën 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ‘Gratë, paqja dhe siguria’ (UNSCR 1325);⁴⁵ dhe
- Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)⁴⁶ dhe Konventën C190 të ILO lidhur me Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës.⁴⁷

Ligji i BE-së për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III i BE-së janë të përafuara me dokumentet e lartpërmendura dhe, si të tillë, përbëjnë një pjesë integrale të procesit të anëtarësimit në BE.

Në nivel kombëtar, Kushtetuta e Shqipërisë ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë (neni 18/2).⁴⁸ Ligji nr.9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”⁴⁹ përkufizon termin “integrim gjinor”. Ligji nr.10221, datë 04.02.2010,

42 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1979). Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Shih: <https://hrrp.eu/alb/docs/CEDAW-a.pdf>

43 Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (2011). Shih: <https://rm.coe.int/168046246b>

44 Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1995). Shih: <https://awenetwork.org/media/6462066697d99.pdf>

45 Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ‘Gratë, paqja dhe siguria’ (2000). Shih: <https://www.unwomen.org/en/docs/2000/10/un-security-council-resolution-1325>

46 Konventat dhe rekomandimet e ILO-s (në internet). Shih: <https://www.ilo.org/global/standards/introduction-to-international-labour-standards/conventions-and-recommendations/lang--en/index.htm>

47 ILO (2019). Konventa nr.190 lidhur me Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës: https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C190; shih gjithashtu: <https://www.ilo.org/global/topics/violence-harassment/lang--en/index.htm>

48 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Gjendet në: <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

49 Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.125, datë 01.08.2008. Shih: https://www.mod.gov.al/Images/PDF/barazia_gjinore_shoqeri.pdf

“Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar në vitin 2020⁵⁰, detyron të gjitha autoritetet publike që të promovojnë barazinë dhe të parandalojnë diskriminimin në ushtrimin e funksioneve të tyre (neni 7 “Mbrojtja nga diskriminimi”). Për më tepër, ligji trajton diskriminimin strukturor dhe diskriminimin për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination), si dhe eliminimin e privilegjeve.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030, e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.06.2021, në qëllimin strategjik IV, përcakton “Aplikimin e integritimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë gjinore dhe drejtësisë gjinore në shoqëri”.⁵¹ Ajo parashikon monitorimin e strategjive të reja në të cilat duhet të integrohet këndvështrimi gjinor, si dhe caktimin e buxheteve përkatëse në nivel qendror dhe vendor. Kështu, SKBGJ-ja përcakton kuadrin strategjik për integrimin gjinor në të gjithë sektorët dhe të gjitha nivelet e qeverisjes.

3.1. Përafrimi me Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së dhe treguesit përkatës

Sikurse evidentohet në dokumente si raportet dhe dosjet gjinore për Shqipërinë, në vend vazhdojnë të ekzistojnë mangësi të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve të pabarazisë gjinore dhe në zbatimin e integritimit gjinor.⁵² Këtu përfshihen fusha të politikave në të cilat statusi i pabarabartë i grave është i mirëdokumentuar dhe i vërtetuar qartë nga të dhënat administrative. Ndër arsyet bazë për këtë janë:

- (i) konceptualizimi stereotipik dhe i gabuar i ‘qytetarit të zakonshëm’, i cili është burrë;
- (ii) kapacitete dhe aftësi të kufizuara për integrimin gjinor në administratë;

50 Ndryshuar me Ligjin nr.124/2020. Shih: <https://mooc.historiaime.al/extra/124dt.15.10.2020.pdf>

51 Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr.112, datë 15.07.2021: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/112>. Versioni në gjuhën angleze gjendet në: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/WEB_Strategjia%20Kombetare%20-%20EN.pdf

52 Komisioni Evropian. Raportet për Shqipërinë të viteve 2017, 2018, 2019 dhe 2020; UN Women dhe UNDP (2016), *Gender Brief Albania 2016*, (Dosja Gjinore Shqipëri 2016), shih: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>; UN Women (2020), *Country Gender Equality Brief Albania 2020*, (Dosja e Barazisë Gjinore e Shqipërisë, 2020), shih: [https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020#:~:text=The%20purpose%20of%20UN%20Women's,Sustainable%20Development%20Goals%20\(SDGs\)](https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020#:~:text=The%20purpose%20of%20UN%20Women's,Sustainable%20Development%20Goals%20(SDGs))

- (iii) mungesa e detyrimit për të kryer analiza gjinore të rregullta, sipas fushave të politikave; dhe
- (iv) pasqyrimi i dobët i normave dhe standardeve gjinore në proceset, procedurat dhe sistemet e qeverisjes.

Një pengesë e mëtejshme është fakti se individët e përfshirë në hartimin e politikave dhe programeve e kanë të vështirë të përcaktojnë saktësisht se cilat janë çështjet gjinore kryesore në fushat konkrete të punës dhe veprimtarisë së tyre. Si rrjedhojë, shumica dërrmuese e politikave, planeve dhe programeve mbeten pa objektiva konkrete për barazinë gjinore.

Politikat publike hartohen dhe zbatohen me synimin e arritjes së rezultateve të caktuara. Treguesit përshkruajnë vlerësuesit rregullatorë të arritjes së këtyre rezultateve. Për sa i përket monitorimit të përparimit të bërë në fushën e barazisë gjinore, treguesit e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025 të BE-së mund të shërbejnë si udhërrëfyes të vlefshëm.⁵³ Ata ilustrojnë se çfarë ndryshimi (pra, çfarë rezultatesh) është i nevojshëm të arrihet dhe të matet në jetën e grave/vajzave dhe burrave/djemve, në një fushë të caktuar të politikave.

Në GAP III të BE-së, për dallimet gjinore në TIK flitet kryesisht në fushën tematike “Trajtimi i sfidave dhe shfrytëzimi i mundësive të ofruara nga tranzicioni i gjelbër dhe transformimi digjital”. Objektivi i përgjithshëm tematik synon arritjen e ndryshimeve në nivelin e ndikimit, ku “Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetin e tyre, të mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë për t’i dhënë formë botës digjitale të së nesërme”. Objektivat tematike të lidhura me këtë fushë specifikojnë më tej përmasat në të cilat duhet të arrihet përparim.

Në kuadrin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, integrimi i barazisë gjinore kërkon që objektivat dhe treguesit e GAP III të BE-së të përfshihen gradualisht në kuadrin e politikave të vendit. Për këtë qëllim, tabela në vijim paraqet përafrimin ndërmjet (i) kapitujve përkatës të BE-së për një fushë të caktuar politikash; (ii) dokumenteve përkatëse të politikave kombëtare që do të përshtaten me konsideratat e BE-së për barazinë gjinore; dhe (iii) objektivate dhe treguesve konkretë të GAP III të BE-së që duhet të përfshihen në kornizat kombëtare të monitorimit. Përafrimi plotësohet me listën e treguesve të OZHQ-ve të lidhur me gjininë, që bëjnë lidhjen midis integritimit gjinor në procesin e anëtarësimit në BE me objektivat e barazisë gjinore në nivel global.

53 Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë (2020). *Objectives and Indicators to Frame the Implementation of the Gender Action Plan III (2021-25)*, p.27. [Objektiva dhe tregues për kornizën e zbatimit të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore III (2021-25), f.27]. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0284>

TABELA 2

Përafrimi i Kapitullit 20 dhe i Kapitullit 25 me treguesit e GAP III të BE-së

Kapitulli 20 – Sipërmarrja dhe Politika Industriale Kapitulli 25 – Arsimi	
Dokumentet strategjike kombëtare përkatëse	<p>Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe Plani i saj i Veprimit</p> <p>Programi i Reformave Ekonomike 2023-2025</p> <p>Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale <i>Broadband</i> 2020-2025</p> <p>Strategjia Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe Plani i Veprimit 2022–2026</p> <p>Strategjia e Specializimit Inteligjent (S3) e Shqipërisë</p> <p>Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023 - 2030</p> <p>Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030</p> <p>Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe Plani i saj i Veprimit.</p>
Objektivi i Përgjithshëm Tematik përkatës i GAP III të BE-së	Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetin e tyre, mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë për t’i dhënë formë botës digjitale të së nesërme

<p>Objektivat tematike përkatëse të GAP III të BE-së</p>	<p>Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetin e tyre, marrin pjesë në mënyrë të barabartë në hartimin e politikave dhe në vendimmarrje lidhur me botën digjitale, në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe përfaqësohen në këto politika dhe vendime</p> <p>Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetin e tyre, kanë akses të barabartë në <i>broadband</i>, teknologji dhe mjete digjitale të përballueshme financiarisht dhe të sigurta</p> <p>Grave, burrave, vajzave dhe djemve u ofrohen dhe marrin pjesë në mënyrë të barabartë në trajnime publike mbi njohuritë digjitale</p> <p>Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetin e tyre, marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në ekonominë digjitale</p> <p>Rritje e aksesit të grave, në gjithë diversitetin e tyre, në punë të denjë në fusha jotradicionale, sidomos në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë (SHTIM) dhe në sektorët ku mbizotërojnë gratë, përfshirë edhe kalimin e grave në sektorin formal të ekonomisë, si dhe trajtimi i tyre me sisteme jodiskriminuese dhe përfshirëse të mbrojtjes sociale</p>
---	---

<p>Treguesit përkatës në GAP III të BE-së</p>	<p>Numri i programeve qeveritare të zbatuara për rritjen e aftësisë së grave për të përfituar nga mundësitë e punësimit dhe sipërmarrjes, përfshirë të sipërmarrjeve sociale, të cilat krijohen në sajë të transformimit digjital</p> <p>Numri i aktorëve përkatës (kompani të sektorit privat, ministri, etj.) që janë ndikuar për të miratuar procese për përmirësimin e fuqizimit ekonomik të grave / për zhdukjen e barrierave ndaj aksesit në treg të grave në një sektor të caktuar (Korniza e Rezultateve e Instrumenteve të Politikës së Jashtme të BE-së - KR-IPJ)</p> <p>Numri i praktikave që synojnë zhdukjen e barrierave që pengojnë aksesin e grave në treg, investime dhe në zhvillimin e biznesit (KR-IPJ)</p> <p>Numri i ndërmarrjeve të reja të drejtuara nga gratë që përfitojnë mbështetje financiare dhe/ose trajnime</p> <p>Numri i grave që përdorin shërbimet ose programet e ofruara nga qendrat digjitale/parqet teknologjike, etj.</p> <p>Numri i grave të emëruara në poste drejtuese të larta në teknologjinë digjitale</p> <p>% e vajzave që kanë akses dhe përdorin mjetet e mësimin digjital nga distanca gjatë krizave, si gjatë krizës së shkaktuar nga Covid-19</p> <p>Numri i grave, burrave, vajzave dhe djemve që marrin pjesë në <i>hackathons</i> digjitale ose aktivitete të tjera për sipërmarrjet e reja digjitale, ndarë më së paku sipas seksit</p>
<p>Treguesit e OZHQ-ve të lidhur me gjininë</p>	<p>Proporcioni i të rejave/rinjve dhe të rriturave/rriturve që kanë aftësi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), sipas llojit të aftësive (Treguesi 4.4.1 i OZHQ) [e parashikuar ndarja sipas seksit]</p> <p>Proporcioni i individëve që zotërojnë telefon celular, ndarë më së paku sipas seksit (Treguesi 5.b.1 i OZHQ)</p>

3.2. Instrumenti i Asistencës së Para - Anëtarësimit (IPA) III: integrimi gjinor sipas 'Rregulloreve të NDICI-t'

Agjenda e Shqipërisë për reforma dhe anëtarësim merr mbështetje të konsiderueshme financiare përmes fondeve të BE-së, si edhe drejtpërdrejt nga shtetet anëtare të BE-së. Bashkimi Evropian, si promovuesi kryesor i barazisë ndërmjet grave dhe burrave në rajon, ka përcaktuar standarde të qarta dhe të përkufizuara shprehimisht në Rregulloret e 'Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar' (NDICI) të Komisionit Evropian që u miratuan në qershor 2021.⁵⁴ Këto rregullore vlejné edhe për veprimtaritë në kuadër të IPA III të BE-së që do të financohen dhe zbatohen në Shqipëri dhe formulojnë shprehimisht kriteret e barazisë gjinore:

"[...] Forcimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave në veprimin e jashtëm të Bashkimit [Evropian] dhe shtimi i përpjekjeve për të arritur standardet minimale të performancës që përcaktohen në Planet e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së, duhet të çojnë në një qasje me ndjeshmëri gjinore dhe transformuese në të gjithë veprimin e jashtëm dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të BE-së. Të paktën 85 % e veprimeve të reja që do të zbatohen në kuadër të këtij instrumenti duhet të kenë barazinë gjinore si objektiv parësor ose të rëndësishëm, sikurse përkufizohet në vlerësuesin e politikave për barazinë gjinore të Komitetit të Ndhmës për Zhvillim të OECD-së. Të paktën 5 % e këtyre veprimeve duhet të kenë si objektiv parësor barazinë gjinore, të drejtat dhe fuqizimin e grave dhe vajzave."⁵⁵

Nën dritën e Rregulloreve të NDICI-t, të cilat parashikojnë objektivin prej 85 për qind veprime me ndjeshmëri gjinore në të ardhmen, qeveria e Shqipërisë duhet të përcaktojë – në terma konkrete – veprimtaritë, strukturat, mekanizmat dhe kapacitetet për zbatimin e veprimeve me ndjeshmëri gjinore, që është kriter dhe parakusht për suksesin në marrjen e fondeve nga IPA III e BE-së.

3.3. Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i OECD-DAC

Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i Komitetit të Ndhmës për Zhvillim

54 RREGULLORJA (BE) 2021/947 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale, ndryshon dhe shfuqizon Vendimin nr. 466/2014/EU dhe shfuqizon Rregulloren (BE) 2017/1601 dhe Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 480/2009. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R0947&from=EN>

55 *Po aty.*, L209/8(44).

i Organizatës së Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (OECD-DAC)⁵⁶ është një instrument tepër i rëndësishëm për kryerjen e monitorimit dhe sigurimin e llogaridhënies në kontekstin e Agjendës 2030. Qëllimi i tij është që të identifikojë mangësitë midis angazhimeve ligjore, politike dhe financiare, si dhe të nxisë përpjekjet për eliminimin e tyre. Për të gjitha programet/veprimet është e detyrueshme kryerja e një analize gjinore dhe ndjekja e qasjes 'mos shkakto dëm'.

Programet/veprimet që janë shqyrtuar kundrejt kritereve të këtij vlerësuesi dhe janë konstatuar se nuk e përmbajnë si synim barazinë gjinore, klasifikohen në kategorinë me 0 pikë. Vlerësimi me 0 pikë duhet të shoqërohet me një shpjegim përshkruar. Programet/veprimet në të cilat barazia gjinore është objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por nuk është arsyeja kryesore për kryerjen e programit/veprimit, klasifikohen me 1 pikë. Programet/veprimet në të cilat barazia gjinore është objektiv kryesor dhe themelor qoftë në hartimin, ashtu edhe në rezultatet e pritshme të tyre, klasifikohen me 2 pikë.

Në Rregulloret e NDICI-t të BE-së – të cilat janë të zbatueshme, për shembull, për Dokumentet e Veprimit të IPA III - përmendet shprehimisht detyrimi për zbatimin e kritereve minimale të përbashkëta për tri kategoritë e vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të DAC të OECD-së. Ato përcaktojnë objektivin që më së paku 85 për qind e të gjitha veprimeve të ndërmarra duhet të përmbushin kriteret për t'u klasifikuar në kategorinë 1, dhe 5 për qind të përmbushin kriteret e kategorisë 2. Në praktikë, klasifikimi me 1 pikë kërkon që veprimet me përgjigjshmëri gjinore të pasqyrohen në nivelin e analizës së problemeve, objektivave, treguesve dhe arritjeve të synuara.

Përkufizimi i Kategorisë 1:

- Barazia gjinore është objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por jo arsyeja kryesore për kryerjen e projektit/programit.
- Objektivi i barazisë gjinore duhet të jetë i formuluar shprehimisht në dokumentacionin e projektit/programit dhe nuk mund të jetë i nënkuptuar apo të merret me mend.
- Krahas objektivave të tjera, projekti/programi synon të ketë një ndikim pozitiv në përparimin e mëtejshëm të barazisë gjinore dhe/ose të fuqizimit të grave dhe vajzave, redukon diskriminimin gjinor ose pabarazitë, ose plotëson nevoja gjinore specifike.

⁵⁶ OECD DAC Network on Gender Equality (GENDERNET) (2016). *Definition and minimum recommended criteria for the DAC gender equality policy marker*. (Përkufizimi dhe kriteret minimale të rekomanduara për vlerësuesin e politikave për barazinë gjinore të DAC). Shih: <https://www.oecd.org/dac/gender-development/Minimum-recommended-criteria-for-DAC-gender-marker.pdf>

TABELA 3

Kërkesat minimale për përmbushjen e kriterëve të Kategorisë 1 të vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të DAC të OECD-së

Niveli	Kriteri	Përmbushja	Veprimi që duhet ndërmarrë për arritjen e tij
Analiza e Problemit	Është kryer një analizë e statusit, rolit, pozicionit dhe gjendjes së grave/vajzave dhe burrave/djemve në lidhje me një fushë të politikave/ sektor/ nënsektor ku është ndërmarrë projekti/programi/veprimi	<input type="checkbox"/>	Në rastet kur analiza gjinore nuk ekziston, ose është e paplotë apo i ka kaluar koha, duhet të porositet/ të ndërmerret një analizë gjinore specifike për sektorin ose nënsektorin
	Konstatimet e nxjerra nga analiza gjinore:		
	- janë përfshirë në përshkrimin e problemit	<input type="checkbox"/>	
	- mbështeten me shifra (statistika gjinore)	<input type="checkbox"/>	
	- janë marrë për bazë në hartimin e projektit/ programit/veprimit	<input type="checkbox"/>	
	Janë përmendur çështjet kryesore të pabarazisë gjinore në fushën e politikave/ sektorin/ nënsektorin konkret	<input type="checkbox"/>	
	Ndërhyrja i përmbahet qasjes “mos shkakto dëm”	<input type="checkbox"/>	
	Të dhënat statistikore dhe treguesit janë ndarë sipas seksit dhe sipas tipareve të tjera të identitetit, aty ku është e zbatueshme	<input type="checkbox"/>	

Objektivat	Prania e të paktën një objektivi të barazisë gjinore (për shembull, formulimi shprehimisht i synimit për arritjen e objektivave të barazisë gjinore), në përputhje me problemet e pabarazisë gjinore të identifikuar dhe detajuara në analizën përshkuese	□	Përfshirja e ekspertizës për integrimin gjinor si pjesë përbërëse e grupeve të punës që hartojnë/ rishikojnë dokumentet
Veprimtaritë	Veprimtaritë e propozuara i përgjigjen posaçërisht situatës së përshkruar të grave/vajzave dhe burrave/djemve, kontribuojnë në arritjen e rezultateve të barazisë gjinore dhe parandalojnë diskriminimin, përfshirë diskriminimin strukturor dhe atë për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination)	□	Përfshirja e ekspertizës për integrimin gjinor si pjesë përbërëse e grupeve të punës që hartojnë/ rishikojnë dokumentet
Treguesit	Objektivi ose objektivat e barazisë gjinore mbështeten me të paktën një tregues me ndjeshmëri gjinore, që mundëson: <ul style="list-style-type: none"> - identifikimin e dallimeve gjinore në përfitimet nga masat e parashikuara - monitorimin e ndikimit të masave/veprimtarive mbi gratë/vajzat dhe burrat/djemtë 	□	Harmonizimi me treguesit përkatës të BE-së dhe ata globalë (si për shembull, OZHQ-të, Eurostat/GAP III i BE-së, dhe të tjerë të ngjashëm)

Rezultatet e synuara	Caktohen vlera specifike të matshme për gratë /vajzat dhe burrat/djemtë	□	Reflektimi i qëllimit për eliminimin e dallimeve gjinore/ për arritjen e rezultateve në fushën e barazisë gjinore në vlerat që vendosen për matjen e rezultateve të synuara
-----------------------------	---	---	---

Për t'u klasifikuar në kategorinë 2 të vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të DAC të OECD-së, barazia gjinore duhet të jetë objektivi kryesor dhe themelor i projektit/programit, si në hartimin e tij ashtu edhe për sa i përket rezultateve të pritshme. Deri tani, numri dhe fushëveprimi i projekteve të financuara në kuadrin e IPA të BE-së që klasifikohen në Kategorinë 2 është shumë i ulët.

Përkufizimi i Kategorisë 2:

- Barazia gjinore është objektivi kryesor dhe themelor i projektit/programit, si në hartimin e tij ashtu edhe në rezultatet e pritshme. Projekti/programi nuk do të ishte ndërmarrë pa këtë objektivi të barazisë gjinore.
- Synimi parësor dhe kryesor në hartimin e projektit/programit është përparimi i mëtejshëm i barazisë gjinore dhe/ose i fuqizimit të grave dhe vajzave, reduktimi i diskriminimit ose pabarazive, ose plotësimi i nevojave gjinore specifike.

4 MJETET KRYESORE PËR INTEGRIMIN GJINOR

Kjo pjesë përmban një numër mjetesh të standardizuara të BE-së për integrimin gjinor që mund të përdoren në rishikimin e politikave, planifikimet strategjike të ministrive të linjës, në programim, hartimin e buxheteve dhe në procese të tjera qeverisëse të ngjashme. Lista e plotë e mjeteve dhe materialeve burimore të standardizuara të BE-së, ku përfshihen edhe përshkrime të hollësishme të mjeteve për integrimin gjinor, gjendet (në gjuhën angleze) në faqen e internetit të Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE), në këtë adresë: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools>

4.1. Analiza gjinore⁵⁷

Analiza gjinore ofron të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për integrimin gjinor në politika, programe dhe projekte. Si procesi që përbën pikënisjen për integrimin gjinor, analiza gjinore identifikon dallimet ndërmjet dhe në radhët e grave/vajzave dhe burrave/djemve për sa i përket pozicionit të tyre relativ në shoqëri dhe shpërndarjes së burimeve, mundësive, kufizimeve dhe pushtetit në një kontekst të caktuar. Në këtë mënyrë, kryerja e analizës gjinore bën të mundur zhvillimin e mëpasshëm të ndërhyrjeve që trajtojnë siç duhet pabarazitë gjinore dhe plotësojnë nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve. Qëllimi i analizës gjinore është të identifikojë dhe të trajtojë pabarazitë gjinore, përmes:

- pranimin të ekzistencës së dallimeve ndërmjet dhe në radhët e grave/vajzave dhe burrave/djemve bazuar në shpërndarjen e pabarabartë të burimeve, mundësive, kufizimeve dhe pushtetit;
- sigurimin që nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve janë identifikuar dhe trajtuar qartë në të gjitha fazat e ciklit të politikave;
- pranimin se politikat, programet dhe projektet kanë ndikim të ndryshëm tek gratë/vajzat dhe burrat /djemtë;
- kërkimin dhe formulimin të mendimeve të grave/vajzave dhe burrave/djemve dhe përfshirjes së kontributeve të tyre si komponentë kritikë në zhvillimin e politikave, programeve dhe projekteve;
- nxitjes së pjesëmarrjes dhe përfshirjes së grave në jetën e komunitetit, jetën politike dhe ekonomike;

⁵⁷ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [në internet]. *Gender Mainstreaming More Tools and Methods: Gender analysis*. (Më shumë mjete dhe metoda për integrimin gjinor: analiza gjinore). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-analysis#:~:text=As%20a%20starting%20point%20for,power%20in%20a%20given%20context>

- mbështetjes së ndërhyrjeve më të informuara, të përgjigjshme gjinore dhe efektive.

Analiza gjinore përfshin marrjen parasysh të përvojave, roleve dhe përgjegjësi të veçanta të grave, dhe shkallën e aksesit të tyre në burime dhe në vendimmarrje. Analiza gjinore përfshin gjithashtu njohjen e pabarazive historike dhe shoqërore me të cilat përballen gratë/vajzat dhe synon të shërbejë si informacion bazë për hartimin e politikave, programeve dhe projekteve që trajtojnë – dhe i ndreqin – këto pabarazi.

Kryerja e një analize gjinore të thelluar dhe të gjithanshme bën të mundur që politikëbërëset/politikëbërësit të kuptojnë pabarazitë gjinore në një kontekst apo sektor të caktuar: ajo bën përshkrimin e stadi aktual të situatave kontekstuale sipas gjinisë, si edhe shqyrton shkaqet dhe pasojat e dallimeve gjinore në grupin e synuar. Shqyrtimi i arsyeve që qëndrojnë në themel të pabarazive dhe diskriminimit gjinor ndihmon në përcaktimin e objektivave dhe masave përkatëse të fokusuara për eliminimin e pabarazive gjinore. Në këtë mënyrë, analiza gjinore kontribuon në përmirësimin e përgjigjshmërisë gjinore të politikave dhe legjislacionit, sepse ofron bazën për të siguruar trajtimin e duhur të nevojave të të gjitha/gjithë qytetareve/qytetarëve: grave, burrave, vajzave dhe djemve.

4.2. Statistikat gjinore mbi digjitalizimin dhe TIK në kontekstin e Shqipërisë

Statistikat gjinore përshkruajnë ose matin pabarazitë gjinore. Ato mbështeten në të dhëna për individët, të ndara sipas seksit, pra të dhëna që mblidhen dhe kategorizohen veçmas për gratë/vajzat dhe burrat /djemtë. Këto të dhëna të ndara sipas seksit pasqyrojnë realitetet e jetës së grave/vajzave dhe burrave/djemve, si dhe çështje të politikave që lidhen me gjininë. Ato bëjnë të mundur matjen e dallimeve ndërmjet grave dhe burrave në aspekte të ndryshme shoqërore dhe ekonomike dhe janë një prej kritereve për sigurimin e statistikave gjinore. Për të monitoruar përparimin faktik në fushën e barazisë gjinore, konceptet, përkufizimet dhe metodat e përdorura në prodhimin dhe analizimin e të dhënave duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë rolet, marrëdhëniet dhe pabarazitë gjinore në shoqëri.⁵⁸

58 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [në internet]. *Gender Mainstreaming – More Tools and Methods – Sex-disaggregated data*. (Më shumë mjete dhe metoda për integrimin gjinor – të dhëna të ndara sipas seksit). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/sex-disaggregated-data#:~:text=Data%20collected%20and%20tabulated%20separately,requirements%20in%20obtaining%20gender%20statistics>

Në Shqipëri, statistikat gjinore botohen çdo vit, përmes vrojtimit të posaçëm të INTSTAT-it për këtë qëllim me titull 'Gra dhe burra në Shqipëri'.⁵⁹ Objektivi kryesor i këtij botimi është që të vëre në dispozicion të dhëna të ndara sipas seksit dhe statistika gjinore për të mundësuar monitorimin e politikave ndërsektoriale në kuadër të arritjes së objektivave të barazisë gjinore dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Në botim përfshihen jo vetëm të dhëna administrative, por edhe të dhëna të bazuara në vrojtimitet sociale që kryen INSTAT-i në nivelin e njësive familjare.

Që nga viti 2018, INSTAT-i ka filluar të kryejë anketën e përvitshme mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në familje dhe nga individët. Ky vrojtım statistikor kryhet me të gjithë individët e grupmoshës 16-74 vjeç dhe familjet me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri. Anketa synon të mbledhë të dhëna mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në nivelin e familjeve dhe individëve, përfshirë edhe të dhëna për pajisjet që përdoren në familje ose nga individët (telefon, pajisje kompjuterike, akses në internet, etj.), si dhe për përdorimin e internetit (e-blerje, e-qeverisje, etj.). Metodologjia dhe pyetësori i përdorur janë të harmonizuara me kërkesat e Eurostatit⁶⁰, dhe procesi i përpunimit të të dhënave dhe llojet e treguesve të përdorur janë të krahasueshëm me ato të vendeve të BE-së.

Përpjekjet e INSTAT-it për harmonizimin e statistikave gjinore kombëtare me ato të Eurostatit janë një proces i pandërprerë dhe që vazhdon edhe sot. Në vitin 2021, baza e të dhënave e INSTAT-it u ristrukturua në përputhje me metodologjinë dhe bazën e të dhënave të Eurostatit. Të gjitha të dhënat administrative u vlerësuan kundrejt treguesve të Eurostatit, ndërsa prodhimi i treguesve të vrojtimitve sociale u bë mbi bazën e një metodologjie të njëzuar. Është e rëndësishme të theksohet se harmonizimi në vijimësi i statistikave – përfshirë edhe statistikat gjinore – është një kërkesë që i kapërcen kufijtë e INSTAT-it. Ajo ka të bëjë me të gjitha institucionet që prodhojnë statistika në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes.

Një numër treguesish të GAP III të BE-së mund të llogariten mbi bazën e informacioneve të marra nga anketimet e kryera nga INSTAT-i (siç janë anketat vjetore të buxhetit të familjes, anketat e forcave të punës, anketat mbi

59 Shih: <http://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/#tab3>

60 Rregullorja (KE) nr.808/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 prill 2004 lidhur me statistikat e Komunitetit mbi shoqërinë e informacionit. Gjendet në: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:143:0049:0055:EN:PDF>

strukturën e të ardhurave), si dhe përmes shkëmbimit të rregullt të të dhënave ndërmjet INSTAT-it, portalit qeveritar 'E-Albania' dhe ADISA-s (shih pjesën 1).

4.3. Vlerësimi i ndikimit gjinor

Vlerësimi i ndikimit gjinor është një metodë e standardizuar e BE-së që përdoret rregullisht për vlerësimin *ex ante* të dokumenteve ligjore, planeve të politikave strategjike dhe programeve në proces zbatimi.⁶¹ Një përdorim më i gjerë i vlerësimit të ndikimit gjinor i ndihmon politikëbërëset/politikëbërësit dhe nëpunëset/nëpunësit publikë që të analizojnë dhe parashikojnë ndikimin që do të ketë tek gratë/vajzat dhe burrat/djemtë çfarëdo vendimi i rëndësishëm që shqyrtohet prej tyre, gjë që do të ndihmojë në përmirësimin e masave ekzistuese dhe do të shërbejë si bazë për marrjen e vendimeve për alokimin e buxheteve. Përfundimet e nxjerra nga çdo vlerësim i ndikimit gjinor duhet të vihen në dispozicion në kohë, në mënyrë që të bëhet i mundur ndryshimi i akteve ligjore dhe politikave të tjera përkatëse gjatë fazave të hartimit dhe planifikimit.

“Vlerësimi i ndikimit gjinor mund të kryhet për aktet legislative, planet e politikave, programet e politikave, buxhetet, veprimet konkrete, projektligjet dhe raportet apo angazhimet për punë kërkimore shkencore. Metodatat e vlerësimit të ndikimit gjinor duhet të zbatohen jo vetëm për politikën që janë në fazën e hartimit; ato mund të zbatohen edhe në kuadër të politikave tashmë ekzistuese. Ato mund të përdoren si në administratë, ashtu edhe nga aktorë të jashtëm; në të dy rastet ato kërkojnë një sasi të konsiderueshme njohurish lidhur me çështjet gjinore.”⁶²

Kohët e fundit, në kuadër të Projektit SANECA të administruar nga GIZ-i, instrumenti i Vlerësimit të Ndikimit Gjinor *ex ante* të BE-së u përshtat për kontekstin shqiptar, me fokus të veçantë mbi përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në të ashtuquajturit “kapitujt e tregut të brendshëm” të BE-

61 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [në internet]. *Gender Mainstreaming - More Tools and Methods: Gender impact assessment*. (Më shumë mjete dhe metoda për integrimin gjinor: Vlerësimi i ndikimit gjinor). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/toolkits/gender-impact-assessment/what-gender-impact-assessment>

62 Këshilli i Evropës (2004). *Gender mainstreaming: Conceptual framework, methodology and presentation of good practices* (Integrimi gjinor: korniza konceptuale, metodologjia dhe prezantimi i praktikave të mira), http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/gender-mainstreaming/EG_S_MS_98_2_rev_en.pdf

së (pra kapitujt 1, 3, 20 dhe 28).⁶³ Në Kosovë, Agjencia për Barazi Gjinore – që operon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit – përgatiti në vitin 2019 një Manual të posaçëm për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor, i financuar nga Suedia.⁶⁴

4.4. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në digjitalizim dhe në TIK

Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor është një proces kryesor për përfshirjen e këndvështrimit gjinor në planifikim. Ai “synon të sigurojë që mbledhja dhe alokimi i burimeve publike të kryhet në mënyra të cilat janë efektive dhe kontribuojnë për të çuar përpara barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave”.⁶⁵ Është e rëndësishme të theksohet që buxhetimi i përgjigjshëm gjinor nuk do të thotë që të krijohet një buxhet i veçantë për gratë, e as që thjesht të shtohen fondet e shpenzuara në programet për gratë. Shembuj se si mund të zbatohet buxhetimi i përgjigjshëm gjinor krahas integritimit gjinor në digjitalizim dhe në TIK janë⁶⁶:

- ✓ Përfshirja e nismave që trajtojnë nevojat dhe kufizimet konkrete me të cilat përballen gratë ose burrat dhe buxhetimi për to.
- ✓ Përfshirja e ndërtimit afatgjatë të kapaciteteve të grave në fushat e aftësive teknike/teknologjike; udhëheqjes dhe aftësive negociuese; si dhe të aftësive dhe ndërgjegjësimit financiar.
- ✓ Alokimi i burimeve për rritjen e ndërgjegjësimit gjinor dhe të kapaciteteve për integrimin gjinor në të gjitha nivelet dhe në mënyra të përshtatura për nevojat e grupeve të ndryshme të synuara, si politikëbërëset/politikëbërësit, personeli i programeve, përfitueset dhe përfituesit, personeli i institucioneve vendore përkatëse, institucionet për ofrimin e shërbimeve, si dhe gratë/vajzat/burrat/djemetë nga komunitetet e pafavorizuara.

63 GIZ (2022). Gender Mainstreaming in the Internal Market Chapters of the Acquis - Guidelines and Tools. (Integrimi gjinor në kapitujt e tregut të brendshëm të *acquis* – Udhëzime dhe mjete). Gjendet në: https://pubhtml5.com/qzcc/xxqj/Gender_Mainstreaming_in_the_Internal_Market_Chapters_of_the_Acquis/3

64 Republika e Kosovës Agjencia për Barazinë Gjinore (2019). Manuali i Vlerësimit të Ndikimit Gjinor. Gjendet në: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Gender%20Equality%20Impact%20Assessment%20Manual.pdf>

65 UN Women Asia Pacific [në internet]. *Gender Responsive Budgeting*. (Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor). Gjendet në: <https://asiapacific.unwomen.org/en/focus-areas/women-poverty-economics/gender-responsive-budgeting>, paragrafi i parë.

66 Komisioni Evropian [në internet]. *Thematic Brief: Gender and Infrastructure, Transport and ICT*. (Dosje tematike: gjinia dhe infrastruktura, transporti dhe TIK). Gjendet në: https://eugender.itcilo.org/toolkit/online/story_content/external_files/TA_Transport.pdf

4.5. Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor

Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor (PPPGJ) është prokurim që nxit barazinë gjinore përmes blerjes së mallrave, shërbimeve apo punimeve. Kjo do të thotë që blerëset/blerësit dhe ofrueset/ofruesit e shërbimeve (i) të analizojnë ndikimin që kanë të gjitha veprimtaritë e kontraktuara mbi nevojat, interesat dhe shqetësimet e grave dhe burrave; dhe (ii) të hartojnë dhe t'i realizojnë kontratat në mënyrë të tillë që redukton pabarazitë. PPPGJ-ja nuk nënkupton domosdoshmërisht shpenzime më të mëdha, por kërkon njohuri dhe kapacitete.⁶⁷ Prokurimi publik dhe akordimi i kontratave kompanive private që punësojnë fuqi punëtore nga jashtë kompanisë mund të sjellë ndikim pozitiv në rritjen e punësimit në nivel vendor në përgjithësi dhe në mundësitë e punësimit të grave në veçanti. Në ftesat për propozime që u paraqiten programeve financuese ose në termat e referencës të procedurave të prokurimit publik mund të përfshihen klauzola që përmendin produktet sociale që synohet të arrihen (për shembull, proporcioni i punëtoreve/punëtorëve vendas të kontraktuar sipas kategorisë; proporcioni i grave që do të punësohen; detyrimi për të zvogëluar pabarazitë gjinore; respektimi i parimeve të barazisë gjinore; dhe të tjera të ngjashme). Klauzola gjinore të tilla mund të përfshihen edhe në ftesat për kontraktorët që do të angazhohen për kryerjen e shërbimeve në mbështetje të politikave. Kjo do të sigurojë që projektet dhe shërbimet që marrin fonde të kenë të përfshirë kapacitetet gjinore, t'u përgjigjen nevojave të ndryshme të grave/vajzave/burrave/djemve, si dhe të kontribuojnë në arritjen e barazisë gjinore.⁶⁸

Komisioni Evropian shprehimisht në Strategjinë e tij për Barazinë Gjinore për 2020-2025 thekson se 'udhëzimet e Komisionit për prokurimin publik me përgjegjësi sociale do të luftojnë diskriminimin dhe do të promovojnë barazinë gjinore në tenderat publikë'.⁶⁹ Si një nga rezultatet e para të Strategjisë, Komisioni ka propozuar masa detyruese për transparencën e pagave sipas projekt-direktivës për transparencën e pagave, e cila trajton në mënyrë

⁶⁷ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [në internet]. *Gender Mainstreaming Methods and Tools* (Metoda dhe mjete për integrimin gjinor). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>

⁶⁸ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2016). *Gender and Digital Agenda*. (Gjinia dhe agjenda digjitale). Gjendet në: <https://eige.europa.eu/publications/gender-and-digital-agenda>

⁶⁹ *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions – A Union of equality: Gender equality strategy 2020–2025, COM(2020) 152, 5.3.2020*. (Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve - Një Bashkim i Barazisë: Strategjia e Barazisë Gjinore 2020–2025, COM(2020) 152, 5.3.2020). Gjendet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0152>

specifike pagën e barabartë dhe hendekun e pagave në kontekstin e prokurimit publik (në nenin 21). Në 24 prill 2023, Këshilli Evropian miratoi rregulla të reja për transparencën e pagave përmes Direktivës për Transparencën e Pagave. Sipas rregullave të reja, kompanive të BE-së u kërkohet të ndajnë informacion mbi pagat dhe të ndërmarrin veprime, nëse hendeku gjinor i pagave të tyre kalon pesë për qind. Direktiva përfshin gjithashtu dispozita për kompensimin e viktimave të diskriminimit në pagë, si dhe dënime, përfshirë gjobat, për punëdhënësit që shkelin rregullat.^{70,71} Për udhëzime të hollësishme të BE-së mbi PPPGJ-në, shihni: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>

Shembuj të tjerë të PPPGJ-së përfshijnë Zvicrën, ku çdo kompani që punon me qeverinë është e detyruar të paguajë në mënyrë të barabartë burrat dhe gratë anëtarë/anëtare të stafit. Në Spanjë, Ligji për Prokurimet Publike përfshin një sërë dispozitash për barazinë gjinore që lidhen me faza të ndryshme të procedurës së prokurimit, nga përzgjedhja e kontraktorit e deri tek zbatimi i kontratave publike. Asnjë person që është i dënuar për shkelje të të drejtave të punëtoresh/punëtorëve, përfshirë sjellje që shkelin të drejtën dhe mundësitë e grave, si diskriminimi apo ngacmimi, nuk mund të nënshkruajë kontrata me institucione të sektorit publik. Kompanitë me më shumë se 250 punonjëse/punonjës që nuk zbatojnë plane të barazisë gjinore janë gjithashtu të ndaluara të marrin pjesë në procedurat e prokurimeve publike.⁷² UN Women promovon metoda të tjera që sjellin përfitime në ekonomi, si (i) mbështetja e rregullave të prokurimit që u japin përparësi ofertave të bizneseve në pronësi të grave; dhe (ii) nxitja e kompanive përtej grupimeve të zakonshme të biznesit, duke zgjeruar kështu gamën e mundësive të punësimit dhe krijuar tregje të reja.⁷³

70 DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL to strengthen the application of the principle of equal pay for equal work or work of equal value between men and women through pay transparency and enforcement mechanisms, 2021/0005(COD), 11 April 2021. (DIREKTIVA E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT për të fuqizuar zbatimin e parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë midis burrave dhe grave nëpërmjet transparencës së pagave dhe mekanizmave të zbatimit, 2021/0005(COD), 11 prill 2021). Shih: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-81-2022-INIT/en/pdf>

71 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [në internet]. *Gender Mainstreaming – More Tools and Methods: Gender-responsive public procurement*. (Më shumë mjete dhe metoda për integrimin gjinor: Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor). Gjendet në: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>

72 UNODC (2020). *The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption*. (Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit). Shih: https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf

73 UN Women (2017). *The Power of Procurement: how to source from women-owned business*. (Fuqia e Prokurimeve: si të furnizohet nga biznese në pronësi të grave). Shih: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2017/3/the-power-of-procurement>

4.6. Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor

Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor përdoret për të treguar nëse në një program të caktuar trajtohen përparësitë dhe nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve. Qëllimi është të vlerësohet nëse programi ka ndikimin e parashikuar (ose edhe ndonjë ndikim të paparashikuar) në marrëdhëniet gjinore dhe të përcaktohen aspektet gjinore që duhen integruar në sistemet e monitorimit dhe të vlerësimit. Një monitorim dhe vlerësim i ndjeshëm gjinor që është efektiv duhet të përfshijë si të dhëna cilësore ashtu edhe sasiore që matin ndikimin mbi marrëdhëniet midis gjinive. Pa të dhëna të mjaftueshme është shumë e vështirë të bëhet një analizë e njëmendtë e ndikimit të programeve mbi barazinë gjinore. Kjo do të thotë që të gjitha të dhënat duhet të mbliidhen, paraqiten dhe analizohen më së paku të ndara sipas seksit.⁷⁴ Gjithashtu, rezultatet dhe informacionet e marra nga monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor shërbejnë si bazë për ciklet e politikave: ato identifikojnë aspektet për të cilat do të duhet të përfshihen objektiva dhe tregues të barazisë gjinore të formuluar shprehimisht në fazën e planifikimit.

⁷⁴ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) *Glossary and Thesaurus* (Fjalor tematik) [në internet]. Gjetendet në: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1217?lang=en>

5 REKOMANDIME TË RËNDËSISHME NË SEKTORIN E DIGJITALIZIMIT DHE TIK

Ndërhyrjet për integrimin gjinor përfshijnë ngritjen e kapaciteteve për kryerjen e analizave gjinore, si dhe angazhimin aktiv të specialisteve dhe specialistëve të integrimit gjinor përgjatë të gjitha fazave të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjive dhe politikave. Për më tepër, politikat ekzistuese në zbatim e sipër duhet të shqyrtohen lidhur me ndjeshmërinë e tyre gjinore (pra, të vlerësohet si i trajtojnë ato pabarazitë gjinore në sektorin/fushën e politikës). Nëse është e nevojshme, këto politika duhet të rishikohen, me qëllim integrimin gjinor në strategjitë sektoriale dhe strukturat, sistemet dhe proceset e të gjitha institucioneve të përfshira.

TABELA 4

Veprime prioritare për integrimin e objektivave të barazisë gjinore në politikat e digjitalizimit dhe në TIK⁷⁵

Çështja kryesore gjinore	Veprime prioritare të politikave
Akses dhe përdorim jo i barabartë i teknologjisë digjitale	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Detajimi i mëtejshëm i treguesve përkatës të TIK-ut, përmes objektivave për sigurimin e aksesit dhe lidhjes sociale dhe me ndjeshmëri gjinore ☑ Kryerja e studimeve të cilat ofrojnë një analizë të thelluar të hendeqeve gjinore (për shembull të dallimeve gjinore në aftësitë digjitale, arsim dhe punësim në SHTIM/TIK, përdorimi dhe aksesit në teknologji i nënkategorive të popullsisë – domethënë, duke i ndarë ato sipas moshës, vendbanimit në qytet/fshat, pa/aftësive, etj.) ☑ Mbledhja e të dhënave të ndara sipas seksit dhe e statistikave gjinore të sakta, në sektorin TIK ☑ Zbatimi i masave të posaçme për eliminimin e hendekut gjinor në aftësitë digjitale, për t'iu përgjigjur mungesave të fuqisë punëtore në tregun përkatës të punës dhe për të reduktuar pabarazitë sociale dhe ekonomike ☑ Hartimi i politikave që fokusohen posaçërisht tek dallimet gjinore në akses dhe përdorim të internetit dhe telefonave celularë ☑ Zbatimi i programeve për forcimin e besimit të vajzave në aftësitë e tyre digjitale, në mënyrë që të sigurohen rezultate arsimore më të kuptimshme dhe të dobishme, si dhe të kontribuohet në rritjen ekonomike

⁷⁵ Rekomandimet janë bazuar në/përshtatur nga: ITU dhe UN WOMEN (2016), *Action Plan to Close the Digital Gender Gap* (Plan veprimi për eliminimin e hendekut gjinor digjital); ITU dhe UN WOMEN (2021), *Digitally Empowered Generation Equality: Women, Girls and ICT in the Context of Covid-19 in Selected Western Balkan and Eastern Partnership Countries* (Fuqizimi digjital i brezit të barazisë: gratë, vajzat dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit në kontekstin e Covid-19 në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe të Partneritetit të Lindjes); Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (2018), *Gender Equality and Digitalisation in the European Union* (Barazia gjinore dhe digjitalizimi në Bashkimin Evropian); OECD (2018), *Bridging the digital gender divide: include, upskill, innovate* (Ngushtimi i dallimeve gjinore digjitale: përfshirje, rritje e aftësive, novacion).

<p>Ndarja gjinore në fushat e studimit (SHTIM, TIK)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Angazhimi në programe dhe nisma konkrete të BE-së, si <i>STEM4youth</i> (SHTIM për rininë) dhe “<i>STEM skills for a future-proof Europe</i>” (Aftësitë SHTIM për një të ardhme të sigurtë në Evropë), përmes bashkëpunimit me sistemet arsimore kombëtare ☑ Zbatimi i masave që i kushtohen posaçërisht krijimit të mjediseve mësimore me ndjeshmëri gjinore në fushat e SHTIM-it ☑ Kryerja e studimeve të mëtejshme mbi modelet e të mësuarit në internet ose modelet hibride, parë nga këndvështrimi gjinor ☑ Zbatimi në sektorin arsimor i masave të reformave për mbështetjen proaktive të aftësive të vajzave në sektorin TIK dhe për rritjen e numrit të vajzave të regjistruara në degët SHTIM ☑ Kurse për shtimin dhe forcimin e njohurive dhe aftësive digjitale të mësueseve/mësuesve, për të siguruar përdorimin efektiv të teknologjisë në shkolla
<p>Pjesëmarrja e ulët e grave në tregun digjital të punës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Ofrimi i kurseve në internet ose përmes materialeve në video për rritjen e aftësive, për t'i ndihmuar gratë t'i përdorin më mirë pajisjet digjitale dhe për të nxjerrë më shumë vlerë prej tyre ☑ Kryerja e studimeve për të hulumtuar mospërputhjen e mundshme midis aftësive akademike të studenteve të diplomuara në fushat SHTIM dhe nevojave reale të tregut për punësim në fushën e teknologjisë ☑ Krijimi i programeve të posaçme për vajzat, për t'i mbështetur ato që të marrin pjesë në tregun e punës pas diplomimit (tranzicioni shkollë-punë) ☑ Bashkëpunimi me sektorin privat për krijimin/sigurimin e një mjedisi pune me ndjeshmëri gjinore dhe që promovon talentet e grave ☑ Nxitja e kompanive në sektorin digjital që të aderojnë në Parimet për fuqizimin e grave⁷⁶

⁷⁶ UN Global Compact dhe UN Women: *Women's Empowerment Principles* (Parimet e fuqizimit të grave). Shih: <https://www.weps.org/about>

	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Përdorimi i udhëzimeve për integrimin e parimeve të barazisë gjinore në procedurat e brendshme dhe në kulturën e vendit të punës në kompanitë e sektorit digjital ☑ Shtimi i investimeve me ndjeshmëri gjinore në kompanitë e reja, përfshirë investimet për gratë ☑ Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht e organizatave të rinisë dhe të grave, për të nxitur pjesëmarrjen e grave dhe të vajzave në ekonominë digjitale
Dhuna ndaj grave, bullizmi në internet, dhuna me bazë gjinore	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Zbatimi i legjislacionit që mbron gratë dhe vajzat nga të gjitha format e ngacmimit dhe të dhunës me bazë gjinore në internet ☑ Punë e mëtejshme mbi programet ekzistuese kombëtare për sigurinë e fëmijëve, që në to të përfshihet qasja me ndjeshmëri gjinore ☑ Reformimi i kuadrit ligjor dhe i kodeve të sjelljes, që të trajtojnë dhunën digjitale, përfshirë dhunën me bazë gjinore
Normat dhe stereotipet gjinore	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Plotësimi i kodeve të sjelljes mbi gjuhën e urrejtjes në internet, që në to të përfshihet edhe dimensionin e dhunës me bazë gjinore ☑ Promovimi i normave gjinore pozitive në internet dhe jashtë tij, për të mbështetur pjesëmarrjen e plotë të vajzave dhe grave në hapësirat digjitale
Mangësitë në statistika gjinore	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që prodhojnë të dhëna dhe INSTAT-it, me qëllim llogaritjen e treguesve gjinorë mbi digjitalizimin dhe sektorin TIK në Shqipëri, që janë të harmonizuar me treguesit e BE-së ☑ Angazhimi në të gjithë hapat e nevojshëm për përgatitjen dhe monitorimin e treguesve gjinorë të harmonizuar me treguesit e BE-së, në sektorin e digjitalizimit dhe TIK në përputhje me metodologjinë e BE-së



DREJTËSIA

MASAT KUNDËR KORRUPSIONIT

SHËNDETËSIA

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

DIGJITALIZIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

ADMINISTRATA PUBLIKE

VETËQEVERISJA VENDORE DHE ZHVILLIMI VENDOR

RINIA